



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:012514

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645808

KPPP.nr. 79/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit V.M. B.I, me numër unik identifikues 810115586 dhe seli në Vushtrri, Dumnicë e Epërme, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 502/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit V.M. B.I, me numër unik identifikues 810115586 dhe seli në Vushtrri, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 502/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 502/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Driton Govori, MBETE NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, mbi bazën e dokumentit përmbarimor; Vendimit Nr. 01/08-124/2023-A, të datës 28.09.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 502/23, të datës 21.12.2023, me të cilin është obliguar debitori V.M. B.I., që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, kreditorit t'ia paguaj në emër të masës ndëshkimore vlerën prej EUR 9,000.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se vendimi në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor është

i kundërligjshëm dhe me të njëjtin është gjobitur biznesi individual pa pasur asnjë lloj përgjegjësie dhe pa bërë shkelje ligjore, ku edhe nga arsyetimi i të njëjtit shihet qartazi se është me të pa vërteta. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të anulohet urdhri përmbarimor.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimin për përmbarim e ka parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të debitorit në mënyrë vullnetare për pagesë të gjobës së shqiptuar të vendimit të formës së prerë të TEIP. Ka shtuar se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor është i bazuar dhe i ekzekutueshëm. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimin Nr. 01/08-124/2023-A, të datës 28.09.2023, mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, është bërë i plotfuqishëm dhe mban vullnetarë ekzekutueshmërisë së datës 29.11.2023, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për*

*përmbaueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”.*

Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njejtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbaueshmëri në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 79/24, datë 02.05.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.